

VENDIM
Nr. 388, datë 9.6.2022

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
KANDIDATURAVE ALTERNATIVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 21, të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturave alternative për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës, si më poshtë vijon:

1. Për anëtarin e parë:

- Znj. Leida Matja;
- Z. Ervin Myftaraj.

2. Për anëtarin e dytë:

- Z. Durim Kraja;
- Z. Pajtim Melani.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama